

01-11-2023

Nr.

7337

PRISHTINË-A

Shpallje Publike

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës, Seksionin V Pikën 3 (c) të Rregullores së KEK-ut Sh .a, dhe nevojave të paraqitura për plotësimin e disa vendeve të lira të punës në Divizionin e DPQ të KEK-ut, Divizioni i Burimeve Njerëzore, më 01.11.2023 publikon shpalljen për pozitat e mëposhtme:

Teknik te makinerisë

(130 krverës)

Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:

Bartësi i kësaj pozite do të përgjigjet për punët në repartet makinerike në njërin nga këto lokacione: Divizioni i Prodhimit të Qymyrit; ose TC Kosova A ose TC Kosova B (si psh. : repartet makinerike të eskavatorët e thëngjillit; ekskavatorët e djerrinës; paluesit e djerrinës; sistemet e transporti të thëngjillit; salle e makinave; kaldajë/kaldatore; objektet të jashtme; sistemi i transportit të hirit; sistemi i transportit të thëngjillit; pajimet makinerike në PKU; serviset/punëtoritë makinerike, ose në repartet tjera makinerike); Kryen punët e mirëmbajtëse mekanike në njërin nga lokacionet e përmendura më lartë (varësisht se ku përcaktohet) sipas urdhërësave të punës dhe udhëzimeve tekniko – teknologjike të dhëna nga inxhinierët e mirëmbajtjes mekanike; Respekton në mënyrë rigorozë udhëzimet tekniko – teknologjike për mirëmbajtje, të cilat janë përgatitur nga inxhinieri përgjegjës; Kryen preventivat e përgatitura nga inxhinieri përgjegjës, dhe me shkrim, përmes formularëve të përgatitur të preventivave. Për problemet eventuale e informon prijësin e ekipit, me theks të veçantë ato probleme që kërkojnë ndaljen e pajisjes; Kujdeset për makineritë/stabilimentet/pajimet, gjendjen teknike të tyre, veglave dhe të pajisjeve të cilat i përdor për kryerjen e punëve; Duhet të dij të lexoj dhe kuptoj dokumentacionin teknik (vizatimet, skemat etj) Bënë prerjen me gaz (autogjen) të detaleve të ndryshme makinerike, ngrohë me gaz detalet si dhe në rast nevojë bëjnë pikjen me aparat për saldime elektrik, pjesët e përgatitura për saldime; Bënë pastrimin e pajisjeve. Pas përfundimit të punës pastron vendin e punës duke larguar edhe pjesët e vjetra të ndërruara; Respekton orarin e punës me përkushtim dhe disiplinë; Kryen punët e dhëna nga prijësi i ekipit apo ndonjë epror tjetër në sistemin ku është caktuar të punoj. Të kërkojë ndihmë nga prijësi i ekipit për zgjedhjen e problemeve specifike; Të përgjigjet në çdo kohë thirrjes për intervenim dhe të vazhdojë punën sipas nevojë edhe pas orarit të rregullt të punës; Zbaton të gjitha rregullat e sigurisë në punë; Kryen edhe punë tjera me kërkesën e eprorëve të tij; Është i autorizuar të kërkojë të gjitha provizionet të përcaktuara në kontratën e tij. **Raportimet:** -I raporton prijësit të ekipit për punë të kryera dhe gjendjen e pajisjeve . **Vartësit e drejtpërdrejtë:** -Bashkëpunon me prijësin e ekipit

Kualifikimet

- **Shkollimi:** Shkolla e mesme teknike (ose shkolla e mesme e makinerisë)
- **Drejtim/dega:** Drejtimi i makinerisë.
- **Profili:** teknik i makinerisë; teknik i prodhimit; teknik i energjetikës; mjeshtër mekanik (axhustator); ose operator i makinave CNC (tornove/ frezave).
- **Aftësi profesionale:** Aftësi që të arrij afate kohore, aftësi për punë ekipore.

KEK-u fton të gjithë të interesuarit, në veçanti të gjinisë femërore, të aplikojnë për pozitat e publikuara.

Për më shumë informata për pozitat e lartpërmendura vizitoni ueb faqen: www.kek-energy.com, ikona 'Shpallje' dhe mund ta shkarkoni Aplikacionin për pozitën që dëshironi të aplikoni.

Ne rast te pikëve te barabarta ne fund te testimit (me shkrim dhe me goje) përparësi do të kenë kandidatët nga komuna e Obiliqit dhe zonat tjera te rrezikuara konform ligjit nr. 05/1-044 .

Vërejtje: Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe te plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese:

1. Forma e aplikacionit e shkarkuar nga uebfaqja e KEK-ut, pas plotësimit duhet të ngarkohet në formën e aplikimit online te vegëza : “ **Ngarko formularin për aplikim – të plotësuar**” (nuk pranohet format tjetër i aplikacionit)
 2. Dëshmie për kualifikimin tuaj: **Diplomën e shkollës së mesme (ose Certifikatën e përfundimit te shkollës se mesme)** e skanoni ne një dokument të vetëm (formati .pdf ose .docx ose .doc, madhësia maksimale 5MB) dhe pastaj e ngarkoni në aplikimin online të vegëza “**Ngarko dëshmitë e kualifikimit** “
- **Kujdes:** Te gjithë aplikantet që nuk i plotësojnë shënimet e sakta në aplikacion (p.sh nuk e deklarojnë se familjari ju punon në KEK), aplikacionet e tyre do ju refuzohen.
 - Dokumentet pas afatit **nuk do të pranohen** ndërsa aplikacionet e mangëta ose qe nuk janë ne formatin e kërkuar më lartë do të refuzohen.
 - Kandidatët me kualifikime me te larta shkollore (inxhinierë ose master), nuk do te kenë përparësi.
 - Aplikantët të cilët nuk janë shtetas të Republikës se Kosovës duhet të kenë leje qëndrimi në Kosovë.
 - Kontrata e punës për të punësuarit për pozitën e zgjedhur do të jetë 1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj.
 - Kandidatët e suksesshëm do të sistemohen në pozitën për te cilën ka aplikuar sipas kësaj shpallje. Nëse tregojnë performancë të mirë ata/ato do të sistemohen në vendin e punës për 3 (tre) vite nga dita e kontratës se parë dhe nuk kane të drejte ri-sistemimi ne vend tjetër te punës.
 - Testimi do të bëhet në formë elektronike ashtu që vlerësimi do të jetë automatik. Procesi i testimit dhe intervistimit për kandidatët e suksesshëm me qëllim të transparencës do të monitorohet nga kamerat.

Prishtinë, 01.11.2023,

Data e aplikimit deri më 16.11.2023 ora 24:00

Divizioni i Burimeve Njerëzore

